



RAPORT GJASHTËMUJ OR

**JANAR –
QERSHOR
2025**



Str. Dimitrie Cupovski 13
1000 Skopje, Macedonia
Tel. +389 (0)2 3239 252
oemvp.org

www.oemvp.org

Përmbajtja

Përmbajtja.....	1
Hyrje	4
1. Sundim i ligjit, institucione efektive me përgjegjësi fiskale dhe financiare si nevojë thelbësore për ekonomi të fuqishme të tregut të lirë	5
1.1 OEMVP ulë në tryezë biznesin dhe qeverinë, në fokus qasja në financa dhe masat qeveritare	5
1.2 Fitore historike e OEMVP, Gjykata Kushtetuese anulon ligjin për tatimin solidar	5
1.3 Delegacioni i OEMVP-së në takim me Presidenten Siljanovska Davkova: Angazhim i përbashkët për zhvillimin ekonomik	6
1.4 Pika e parë strategjike e OEMPV “Sundim i ligjit, institucione efektive me përgjegjësi fiskale dhe financiare si nevojë thelbësore për ekonomi të fuqishme të tregut të lirë”	6
Informatori ligjor Juris dhe Juris Alarm	7
2. Fuqi punëtore të mjaftueshme dhe të kualifikuar me një ekonomi diverze dhe zhvillimore që parandalon emigrimin.....	8
2.1 Qyra në ceremoninë e ndarjes së bursave të organizuar nga <i>Fondacioni Albiz</i> : Investimi tek studentët është çelësi i suksesit.....	8
2.2 OEMVP apel prindërve dhe nxënësve: “Zgjidhni shkollat e mesme profesionale”	8
3. Shtet Evropian, anëtare e BE-së, me institucione dhe biznese moderne të digjitalizuara dhe të drejtuara drejt ekonomisë cirkulare dhe burimeve të ripërtitshme të energjisë	9
3.1 Promovimi i Praktikave ESG.....	9
3.2 Zhvillohet takim mes OEMVP dhe Zv.Ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave. Në fokus mbështetja e sektorit agro-industrial	10
3.3 Njoftim mbi fillimin e Anketës për Opinionin Ekzekutiv.....	10
Informatori ekonomik ECONOMICUS	10
Biznes Informatori DOBIA	11
4. Odë me kredibilitet dhe përfshirje lokale dhe rajonale, lidere në mbrojtje të interesave afariste	12
4.1 OEMVP mirëpret kryesinë e Shoqatës së Industrialistëve dhe Biznesmenëve Eskişehir Rumeli	12
4.2 U realizua mbledhja e I-rë e Këshillit Drejtues të OEMVP për vitin 2025	13
4.3 "OEMVP mysafire e Aleancës Kosovare të Bizneseve me rast të manifestimit të 17-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës"	13
4.4 Takim mes Grupacionit të Ndërtimtarisë, Urbanizmit, Mjedisit dhe Energjetikës të OEMVP dhe Drejtorisë së të Ardhurave Publike	13
4.5 OEMVP nderohet me pllakë jubilarë nga Kryqi i Kuq në 80-vjetorin e themelimit.....	14
4.6 OEMVP organizon Iftarin Tradicional, duke promovuar solidaritetin dhe bashkëjetesën.....	15

4.7 Realizohet takim mes OEMVP dhe MPJTJ. Diskutohet rreth mundësive të bashkëpunimit për stimulim të eksportit.....	15
4.8 Drejtori ekzekutiv i OEMVP, z. Durim Zeqiri pjesëmarrës në Konferencën Rajonale të ESG në WB616	
4.9 Realizohet Mbledhja e II-të e Këshillit Drejtues të OEMVP. U diskutuan prioritetet për periudhën që vijon	16
4.10 Maison de Parfum Skopje, kompania anëtare e OEMVP, hap dyert për vizitë ekskluzive	17
4.11 Eksplorimi i tregjeve të reja: OEMVP organizon pjesëmarrjen e bizneseve anëtare në një nga panairët më të rëndësishme ndërkombëtare të ndërtimtarisë - CF Istanbul”	17
4.12 U realizua takimi ndërmjet Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore dhe Odës Ekonomike të Kosovës: Forcohet Bashkëpunimi Ekonomik Rajonal.....	18
4.13 OEMVP pjesëmarrëse në panairin “Medical and beauty fair – Tirana”	18
4.14 Zhvillohet takim mes OEMVP dhe Prishtina REA – Në fokus bashkëpunimi për ndërlidhje të bizneseve	19
4.15 Kompanitë e OEMVP-së në skenën ndërkombëtare të ndërtimit në Stamboll	19
4.16 Super Kompani prezente në panairin ndërkombëtar të ndërtimit në Bursë, Turqi	20
4.17 Kryetari i OEMVP, z. Mendi Qyra, dhe Drejtori, z. Durim Zeqiri, të pranishëm në ceremoninë e pranim-dorëzimit të detyrës së Rektorit të ri të Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup	20
4.18 Panairi i Karrierës në Universiteti i Tetovës - UT bashkon studentët me biznesin – pjesëmarrës edhe Kryetari i OEMVP-së, z. Mendi Qyra	21
4.19 OEMVP pjesëmarrëse në takime B2B me delegacionin e kompanive turke në Tiranë	21
4.20 Birraria Shkup, EVN, Eko fluid dhe Sparkasse Bank mbështetin aksionin “Generalka Weekend 2025” për një të ardhme të gjelbër	22
4.21 OEMVP mirëpret studentët e Fakultetit të Biznesit dhe Ekonomisë të South East European University (SEEU)	22
4.22 OEMVP pjesëmarrëse në konferencën ekonomike të organizuar nga Rrjeti Global i Bizneseve Shqiptare	23
4.23 OEMVP mirëpret në takim udhëheqësinë e Lidhjes së Bizneseve të Kosovës	23
4.24 OEMVP zhvillon Mbledhjen e III-të të Këshillit Drejtues në Strugë	24
4.25 OEMVP në skenën digjitale të Ballkanit – Jeton Asani flet për fuqinë e teknologjisë në biznes	24
4.26 OEMVP realizoi me sukses mbledhjen e Kuvendit vjetor për vitin 2025	25
4.27 Kryetari dhe Drejtori ekzekutiv së bashku me kompani anëtare të OEMVP të pranishëm në Panairin e përgjithshëm ndërkombëtar “Prishtina 2025”	25
4.28 Kompania anëtare e OEMVP, BE-DA Logistics pjesëmarrëse në panairin “Transport Logistic 2025” në Mynih	26
4.29 OEMVP mirëpret në takim kryesinë e Klubit të Biznesit Maqedoni-Gjermani	26

4.30 Drejtori ekzekutiv i OEMVP në vizitë te kompania anëtare Tiamo – model suksesi i industrisë vendore	27
4.31 "OEMVP hap kampanjën e 20-vjetorit: 2 dekada rrugëtim i përbashkët, fillojnë me një marsh simbolik drejt Ujëvarave të Kamjanit"	27
4.32 Kryetari Mendi Qyra, Drejtori Durim Zeqiri dhe Kryetari i Grupacionit të energjetikës z. Morina pjesëmarrës në MEF Energy Forum 2025	28
4.33 Drejtori Ekzekutiv, z. Durim Zeqiri, folës në forumin Rinor për demokracinë ekonomike dhe pronësinë e punonjësve.....	28
4.34 OEMVP mirëpret Kryetarin e Odës Ekonomike Brazilo-Maqedonase: Hapet perspektiva për bashkëpunim Maqedoni e Veriut-Brazil.....	29
5. Zvogëlimi i ekonomisë gri (joformale), minimizimi i korrupsionit dhe konkurrencës jo lojale si parakusht i konkurrueshmërisë së shëndoshë ekonomike	30
5.1 Fushata e OEMVP për sensibilizim kundër Ekonomisë gri (joformale)	30
5.2 OEMVP me kërkesë zyrtare: Sektori i ndërtimtarisë të përjashtohet nga ndalesa e punës të dielave	30
6. Mbledhjet e organeve të OEMVP	31
7. Marrëdhëniet me publikun	32
7. Komunikimi me anëtarët	35
8. OEMVP në media	35
9. OEMVP në rrjetet sociale	36
Shërbimet e OEMVP	37

Hyrje

Raporti gjashtë mujor i OEMVP është dokument i cili në bazë të statuti përgatitet nga Zyra ekzekutive e Odës dhe përmban përshkrim të shkurtuar të aktiviteteve të OEMVP-së për periudhën e raportimit. Në periudhën Janar – Qershor 2025, OEMVP me qëllim të realizimit të vizionit, misionit dhe qëllimeve strategjike afatgjate të OEMVP-së ka organizuar aktivitete të ndryshme duke vazhduar të etablohet si një institucion i mirëfilltë dhe profesional i drejtuar në përkrahjen dhe avancimin e bizneseve në vend dhe më gjerë.

Strategjia e OEMVP-së për vitin 2024 – 2027 është e bazuar mbi kontekstin e përgjithshëm, nevojat prioritare, aktivitetet e aktorëve tjerë si dhe mbi rolin e vet, dhe ka të definuara pesë objektiva strategjike. Bazuar në vizionin dhe misionin, po ashtu edhe në qëllimet afatgjate të Odës, gjatë kësaj periudhe jemi angazhuar në arritjen e këtyre qëllimeve strategjike:

1. Sundim i ligjit, institucione efektive me përgjegjësi fiskale dhe financiare si nevojë thelbësore për ekonomi të fuqishme të tregut të lirë.
2. Fuqi punëtore të mjaftueshme dhe të kualifikuar me një ekonomi diverze dhe zhvillimore që parandalon emigrimin.
3. Shtet Evropian, anëtare e BE-së, me institucione dhe biznese moderne të digjitalizuara dhe të drejtuara drejt ekonomisë cirkulare dhe burimeve të ripërtitshme të energjisë.
4. Odë me kredibilitet dhe përfshirje lokale dhe rajonale, lidere në mbrojtje të interesave afariste.
5. Zvogëlimi i ekonomisë gri (joformale), minimizimi i korrupsionit dhe konkurrencës jo lojale si parakusht i konkurrueshmërisë së shëndoshë ekonomike.

Durim Zekiri

Drejtor Ekzekutiv

1. Sundim i ligjit, institucione efektive me përgjegjësi fiskale dhe financiare si nevojë thelbësore për ekonomi të fuqishme të tregut të lirë

1.1 OEMVP ulë në tryezë biznesin dhe qeverinë, në fokus qasja në financa dhe masat qeveritare

16.01.2025, Shkup – Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Përëndimore organizoi Ditë të Hapur mes bizneseve anëtare të Odës dhe përfaqësuesve të Qeverisë, ku i pranishëm ishte zv.kryeministri z. Izet Mexhiti, si dhe drejtori i Agjencisë për investime të huaja dhe promovim të eksportit, z. Refik Xhemaili.



Kjo ditë e hapur u organizua me qëllim që biznesi dhe përfaqësuesit e shtetit të diskutojnë hapur për problemet me të cilat ballafaqohen kompanitë në vendin tonë, dhënien e sugjerimeve, por edhe krijimin e masave dhe mundësive për zhvillim sa më të shpejt të bizneseve dhe ekonomisë së vendit.

1.2 Fitore historike e OEMVP, Gjykata Kushtetuese anulon ligjin për tatimin solidar

05.02.2025 - Gjykata Kushtetuese, solli vendim në favor të OEMVP-së, lëndë ankimese, të cilën edhe zyrtarisht Oda e dorëzoi në Gjykatën Kushtetuese me datë 25.10.2023.

Në konferencë për shtyp, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, z. Darko Kostadinovski, u shpreh se kompanitë kanë afat deri në 5 vite, të kërkojnë që tu kthehen paratë, në rast se u është bërë padrejtësi.

OEMVP që në përgatitjet dhe miratimin e këtij ligji, ishte kategorike se e njëjta është kundër kushtetuese dhe me partnerët e saj "Lansky, Ganzger, Zeqiri + Partner Skopje", dolën fitimtarë duke i mbrojtur si asnjëherë më parë, interesat e biznesit vendor dhe të anëtarësisë së saj.



1.3 Delegacioni i OEMVP-së në takim me Presidenten Siljanovska Davkova: Angazhim i përbashkët për zhvillimin ekonomik

20.02.2025, Shkup - Kryetari i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore z. Mendi Qyra, i shoqëruar nga Kryetari i Nderit, z. Xhemail Dauti, dhe Drejtori Ekzekutiv, z. Durim Zeqiri, u pritën në takim zyrtar nga Presidentja e Republikës së Maqedonisë së Veriut, znj. Gordana Siljanovska Davkova.



Në fjalën e tij, kryetari Qyra theksoi se OEMVP mbetet e përkushtuar ndaj tre shtyllave kryesore, të cilat janë parakushte për zhvillimin ekonomik të vendit: luftimi i korrupsionit, formalizimi i ekonomisë gri dhe sundimi i ligjit. Një nga sfidat kryesore që vazhdon të pengojë zhvillimin e sektorit privat është mungesa e fuqisë punëtore në vend. Në këtë drejtim, z. Qyra prezantoi para presidentes konceptin e OEMVP për rritjen e pagës minimale, duke theksuar se është e domosdoshme të shfrytëzohet maksimalisht potenciali vendor përpara se të kërkohet fuqi punëtore nga jashtë. Të dyja palët u dakorduan se kjo çështje kërkon zgjidhje të qëndrueshme, e cila duhet të nisë me reforma thelbësore në sistemin arsimor.

1.4 Pika e parë strategjike e OEMPV “Sundim i ligjit, institucione efektive me përgjegjësi fiskale dhe financiare si nevojë thelbësore për ekonomi të fuqishme të tregut të lirë”

15.05.2025 - Strategjia e OEMVP-së për vitin 2024 – 2027 është e bazuar mbi kontekstin e përgjithshëm, nevojat prioritare, aktivitetet e aktorëve tjerë si dhe mbi rolin e vet, dhe ka të definuara pesë objektiva strategjike.

Në vijim, mund të shihni grafikonin që ilustron pikën e parë strategjike, e cila fokusohet në sundimin e ligjit, institucione efektive me përgjegjësi fiskale dhe financiare si nevojë thelbësore për ekonomi të fuqishme të tregut të lirë.



Informatori ligjor Juris dhe Juris Alarm

Gjatë kësaj periudhe OEMVP publikoi Informatorin ligjor JURIS dhe Juris Alarm. Temat që u publikuan në këtë informator ligjor ishin:

- **JURIS nr.1** - Vendim për kushte të veçanta të tregtisë për disa mallra dhe detyrimin e tregtarëve për sigurimin dhe shitjen e llojeve dhe sasive të caktuara të këtyre mallrave tek konsumatorët, sipas një radhe të caktuar
- **JURIS nr.2** - Ligji për angazhimin e personave me punë
- **JURIS Alarm nr.1** - Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të mbrojtjes së konsumatorëve
- **JURIS Alarm nr.2** - Ligji i Energjetikes

2. Fuqi punëtore të mjaftueshme dhe të kualifikuar me një ekonomi diverze dhe zhvillimore që parandalon emigrimin

2.1 Qyra në ceremoninë e ndarjes së bursave të organizuar nga *Fondacioni Albiz*: Investimi tek studentët është çelësi i suksesit

19.02.2025, Shkup - OEMVP si institucion i rëndësishëm, përkrah të rinjtë që ndjekin rrugën e zhvillimit profesional. Kështu deklaroi kryetari i Odës, Mendi Qyra, në fjalën e tij në ceremoninë e ndarjes së Bursave për studentët, të organizuar nga Fondacioni ALBIZ. Qyra nënvizoi se investimi në arsim dhe tek kuadrot e rinj, është çelësi i zhvillimit ekonomik dhe social të shoqërisë sonë.



“Jemi thellë të bindur se rrugën të cilën e kemi marrë, është e duhura dhe se argument për këtë është vetë ekzistimi i institucionit tuaj (ALBIZ) për më tepër se një dekadë. Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore, si përfaqësuese e sektorit privat, është gjithmonë e gatshme të mbështesë iniciativa të tilla, sepse një sistem i fortë arsimor është faktor kyç për një të ardhme të sigurt të brezave që vijnë. Por ne si komunitet i biznesit mendojmë se në momente të caktuara, duhet ta zhveshim petkun e modestisë, dhe më zëshëm të promovojmë arritjet tona si Fondacioni ALBIZ, poashtu edhe Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore”, tha kryetari Mendi Qyra.

2.2 OEMVP apel prindërve dhe nxënësve: “Zgjidhni shkollat e mesme profesionale”

19.06.2025 – Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore ju bën thirrje nxënësve që kanë përfunduar arsimin fillor të orientohen drejt shkollave të mesme profesionale, në drejtimet që ofrojnë aftësi konkrete dhe praktike për tregun e punës. Fuqizimi i arsimit profesionit është thelbësor për krijimin e kuadrove të kualifikuara dhe për ndërtimin e një fuqie punëtore të qëndrueshme dhe konkurruese.

Veçanërisht inkurajojmë orientimin drejt profesioneve deficitare, ku kërkesa në treg është në rritje dhe mundësitë për punësim janë të sigurta.

OEMVP APEL PRINDËRVE DHE NXËNËSVE: “ZGJIDHINI SHKOLLAT E MESME PROFESIONALE”

Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore ju bën thirrje nxënësve që kanë përfunduar arsimin fillor të orientohen drejt shkollave të mesme profesionale, në drejtimet që ofrojnë aftësi konkrete dhe praktike për tregun e punës. Fuqizimi i arsimit profesional është thelbësor për krijimin e kuadrove të kualifikuara dhe për ndërtimin e një fuqie punëtore të qëndrueshme dhe konkurruese.

Veçanërisht inkurajojmë orientimin drejt profesioneve deficitare, ku kërkesa në treg është në rritje dhe mundësitë për punësim janë të sigurta.

OEMVP inkurajon dhe mbështet çdo nismë që e lidh arsimin me ekonominë dhe kontribuon në zhvillimin afatgjatë të kapitalit njerëzor në vend.

WWW.OEMVP.ORG



OEMVP inkurajon dhe mbështet çdo nismë që e lidh arsimin me ekonominë dhe kontribuon në zhvillimin afatgjatë të kapitalit njerëzor në vend.

3. Shtet Evropian, anëtare e BE-së, me institucione dhe biznese moderne të digjitalizuara dhe të drejtuara drejt ekonomisë cirkulare dhe burimeve të ripërtrithshme të energjisë

3.1 Promovimi i Praktikave ESG

24.02.2025, Shkup - Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore, në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë, organizoi një trajnim mbi “Promovimin e praktikave të ESG (Mjedisit, Shoqërisë dhe Qeverisjes) në Ballkanin Perëndimor”.

Ky trajnim i dizajnuar për të pajisur bizneset, OJQ-të dhe institucionet akademike me njohuritë dhe mjetet e nevojshme për të integruar në mënyrë efektive parimet ESG në punën e tyre, përfshiu tematika kryesore si standardet ESG, raportimi, menaxhimi i rreziqeve dhe identifikimi i mundësive për zhvillimin e biznesit të qëndrueshëm.



3.2 Zhvillohet takim mes OEMVP dhe Zv.Ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave. Në fokus mbështetja e sektorit agro-industrial

10.02.2025, Shkup – Kryetari i OEMVP z. Mendi Qyra së bashku me Drejtorin Ekzekutiv z. Durim Zeqiri, Kryetarin e Grupacionit për bujqësi dhe zhvillim rural z. Arben Halili dhe nënkryetarin e Kuvendit, z. Kasam Zendeli u pritën në takim nga zv. Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, z.Flakron Bexheti, ku u diskutua për mundësitë e bashkëpunimit mes të dyja palëve, me qëllim krijimin e kushteve më të favorshme për bizneset që operojnë në këtë fushë.



Kryetari i OEMVP, z. Mendi Qyra, nënvizoi se Maqedonia e Veriut ka të gjitha parakushtet për të zhvilluar një sektor konkurrues bujqësor, por nevojiten masa mbështetëse më të fuqishme nga institucionet shtetërore për të rritur investimet, modernizuar teknologjitë dhe fuqizuar prodhuesit vendorë.

3.3 Njoftim mbi fillimin e Anketës për Opinionin Ekzekutiv

26.03.2025 – Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore, si partner institucional i Forumit Botëror Ekonomik, për 7 vite radhazi, edhe këtë vit ka nisur implementimin e “Anketës për Opinionin Ekzekutiv” për vitin 2025.

Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore, si partner institucional i **Forumit Botëror Ekonomik** (World Economic Forum) për 7 vite radhazi, edhe këtë vit ka nisur implementimin e “Anketës për Opinionin Ekzekutiv” (Executive Opinion Survey) për vitin 2025.

Përveç përfaqësimit të Maqedonisë së Veriut, OEMVP është përfaqësuese edhe për Republikën e Kosovës, ku anketën “Executive Opinion Survey” për Kosovë, e realizon në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës (DHTIK). Ky sondazh ofron mundësinë që kompanitë anëtare të shprehin pikëpamjet e tyre dhe të kontribuojnë në shpërfaqjen dhe pasqyrimin e nivelit real të konkurrueshmërisë së vendeve tona, respektive në raport me konkurrencën globale, ku në raport radhiten plotë 107 shtete.

Duke qenë se ky është një ndër raportet më relevante në nivel global, ftojme kompanitë anëtare për të vazhduar me bashkëpunimin e krijuar vite më parë, kështu duke kontribuar në përmirësimin e klimës biznesore dhe përmirësimin e performancës së institucioneve publike.



Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025 janë publikuar 5 edicione të informatorit ekonomik ECONOMICUS. Temat të cilat janë prezantuar në këto informatorë ekonomikë janë:

- **Economicus nr.1** – Energjia elektrike, gazi natyror, qymyri dhe produktet e naftës, nëntor 2024
- **Economicus nr.2** – Indeksi i çmimeve në bujqësi, janar 2025
- **Economicus nr.3** - Popullsia aktive në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2024
- **Economicus nr.4** - Indekset e kostove për jetesë dhe çmimet me pakicë, mars 2025
- **Economicus nr.5** - "Tregtia e Jashtme, janar-shkurt 2025", maj 2025

Biznes Informatori DOBIA

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025 anëtarët e OEMVP kanë pasur mundësi të njoftohen nëpërmjet informatorit ekonomik DOBIA për thirrje publike në lidhje me grante dhe mundësi për financim. Gjatë kësaj periudhe përmes e-mailit janë dërguar tek anëtarët 10 edicione të informatorit, ndërsa njoftimi për dërgimin e të njëjtëve është shpërndarë edhe në rrjetet sociale të Odës.

Thirrjet të cilat janë të përfshira në këtë periudhë janë:

- **Dobia nr.1** – Thirrje publike - Për paraqitjen e kërkesave për mbështetje financiare nga IPARD – “Investime në mjete themelore të ekonomive bujqësore”
- **Dobia nr.2** – Thirrje publike - Konkurs për ndarjen e mjeteve për financimin dhe realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të tjera në mjedisin jetësor për vitin 2025
- **Dobia nr.3** – Thirrje publike - 02/2025 për masën 112 “Ndihmë për fermerët e rinj për fillimin e veprimtarisë bujqësore”
- **Dobia nr.4** – Thirrje publike për kooperativat bujqësore.
- **Dobia nr.5** – Thirrje publike - Përmbledhje të masave të parashikuara në Planin operativ për punësim, 2025, nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- **Dobia nr.6** – Thirrje publike - Kompensimi i një pjese të shpenzimeve të NMVM për çertifikimin e sistemit HALLALL dhe Kompensimin e një pjese të shpenzimeve të NMVM për çertifikimin e sistemeve të cilësisë sipas standardeve ISO.
- **Dobia nr.7** – Thirrje publike - Mbështetje për rritjen e konkurrueshmërisë së subjekteve afariste nga industria përpunuese – zhvillimi i subjekteve afariste, zhvillimi i produkteve dhe zhvillimi i tregut
- **Dobia nr.8** – Thirrje publike - Për punëdhënësit për masën 3.1, trajnimi në vendin e punës për punëdhënësit konkret.
- **Dobia nr.9** – Thirrje publike - Për subvencionimin e zejtarëve
- **Dobia nr.10** – Thirrje publike - Drejtuar punëdhënësve nga ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, ndërmarrjeve sociale dhe organizatave të shoqërisë civile

4. Odë me kredibilitet dhe përfshirje lokale dhe rajonale, lidere në mbrojtje të interesave afariste

4.1 OEMVP mirëpret kryesinë e Shoqatës së Industrialistëve dhe Biznesmenëve Eskişehir Rumeli

20.01.2025, Shkup - Në hapësirat e OEMVP, Kryetari i Kuvendit të Odës z. Nazmi Ejupi së bashku me Drejtorin Ekzekutiv dhe anëtarë të Këshillit drejtues, zhvilluan takim me Kryetarin e Shoqatës së Industrialistëve dhe Biznesmenëve Eskişehir Rumeli, z.Rustu Sentuna së bashku me përfaqësues tjerë po nga i njëjti institucion.

Ky takim u fokusua në avancimin e bashkëpunimit të ndërsjellë midis anëtarëve të të dyja palëve, si dhe nxitjen e shkëmbimit tregtar me bizneset nga rajoni dhe më gjerë. Në diskutim u theksuan rëndësia e partneriteteve strategjike, krijimi i mundësive të reja për investime si dhe mundësia e rritjes së bashkëpunimit global në interes të zhvillimit ekonomik.



4.2 U realizua mbledhja e I-rë e Këshillit Drejtues të OEMVP për vitin 2025

28.01.2025, Shkup - Në hapësirat e Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore u realizua mbledhja e I-rë e Këshillit Drejtues për vitin 2025, ku u diskutuan arritjet kryesore të odës gjatë vitit që lamë pas por edhe prioritetet kryesore për zhvillimin dhe ecurinë e mëtejshëm të Odës.



Në këtë takim, u shqyrtua efikasiteti i strukturave drejtuese të Odës dhe u vlerësuan sukseset e arritura gjatë vitit të kaluar, të cilat dëshmojnë përkushtimin dhe rolin proaktiv të OEMVP në mbështetjen e sektorit të biznesit.

Gjatë vitit 2024, OEMVP shënoi arritje të rëndësishme, përfshirë miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe sjelljen e Ligjit për Ndalimin e Praktikave të Padrejtë Tregtare, duke mbrojtur konkurrencën e ndershme.

4.3 "OEMVP mysafire e Aleancës Kosovare të Bizneseve me rast të manifestimit të 17-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës"

17.02.2025, Shkup - Kryetari i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, z. Mendi Qyra, së bashku me Kryetarin e Kuvendit të OEMVP, z. Nazmi Ejupi, Kryetarin e Nderit, z. Xhemal Dauti, dhe Drejtorin Ekzekutiv, z. Durim Zekiri, morën pjesë në ngjarjen solemne të organizuar nga Aleanca Kosovare e Bizneseve, me rastin e 17-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.

Në fjalimin e tij përshëndetës, kryetari Qyra uroi të gjithë të pranishmit për këtë ditë historike, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit strategjik ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.



4.4 Takim mes Grupacionit të Ndërtimtarisë, Urbanizmit, Mjedisit dhe Energjetikës të OEMVP dhe Drejtorisë së të Ardhurave Publike

18.02.2025, Shkup – Në hapësirat e Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore u zhvillua takim mes përfaqësuesve të Drejtorisë së të Ardhurave Publike (DAP) dhe kompanive anëtare të Grupacionit të Ndërtimtarisë, Urbanizmit, Mjedisit dhe Energjetikës.

Drejtori i OEMVP, Durim Zeqiri përshëndeti këtë nismë të Drejtorisë së të Ardhurave Publike, duke vlerësuar qasjen pro aktive dhe bashkëpunimin e ndërsjellë për të siguruar zbatim efikas të politikave tatimore. Ai gjithashtu theksoi gatishmërinë e kompanive anëtare të Odës për të qenë pjesëmarrës aktiv në diskutime të tilla, të cilat kontribuojnë në forcimin e sektorit privat dhe krijimin e një klime më të favorshme për investime.



4.5 OEMVP nderohet me pllakë jubilarë nga Kryqi i Kuq në 80-vjetorin e themelimit

05.03.2025, Shkup - Kryetari i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, z. Mendi Qyra mori pjesë në ngjarjen solemne të organizuar me rastin e 80-vjetorit të themelimit të Kryqit të Kuq të Maqedonisë së Veriut.

Gjatë kësaj ngjarjeje, OEMVP u nderua me një pllakë jubilarë, një shenjë falënderimi për mbështetje dhe kontributin e çmuar që ka dhënë në realizimin e iniciativave humanitare të organizatës. Ngjarjet e tilla janë mundësi për të reflektuar mbi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve dhe organizatave, të cilat kontribuojnë në mbështetje të kategorive të ndryshme të shoqërisë dhe për të theksuar sukseset e arritura gjatë kësaj periudhe të gjatë.



4.6 OEMVP organizon Iftarin Tradicional, duke promovuar solidaritetin dhe bashkëjetesën

06.03.2025, Shkup – Me rastin e muajit të shenjtë të Ramazanit, Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore në ambientet e anëtarit të saj, Restorant Nita Palace organizoni Iftarin Tradicional duke mbledhur përfaqësues të biznesit, institucioneve dhe komunitetit në një mbrëmje të mbushur me frymën e solidaritetit dhe mirëkuptimit.

Pjesëmarrës në këtë ngjarje të rëndësishme ishte edhe Kryeministri i Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Hristijan Mickoski, i cili me praninë e tij dha një mesazh të fortë për rëndësinë e dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve dhe sektorëve të ndryshëm të shoqërisë.



4.7 Realizohet takim mes OEMVP dhe MPJTJ. Diskutohet rreth mundësive të bashkëpunimit për stimulim të eksportit

11.03.2025, Shkup - Në hapësirat e Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, Drejtori Ekzekutiv z. Zeqiri priti në takim përfaqësues nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregti të Jashtme, me qëllim të diskutimit për mundësi bashkëpunimi me kompanitë anëtare të Odës.

Z. Zekiri prezantoi punën dhe dinamikat e Odës, duke theksuar disa nga pikat kyçe strategjike në kuadër të Platformës për zhvillim ekonomik të RMV. U potencua rëndësia e fuqisë punëtore të mjaftueshme dhe të kualifikuar, me një ekonomi diverze dhe zhvillimore që parandalon emigrimin, ku në këtë drejtim OEMVP zëshëm ka propozuar masa konkrete për parandalimin e këtij fenomeni. U diskutua edhe rreth kompanive anëtare të Odës të cilat eksportojnë jashtë vendit, duke kontribuar në mirëqenien ekonomike të Maqedonisë së Veriut.



4.8 Drejtori ekzekutiv i OEMVP, z. Durim Zeqiri pjesëmarrës në Konferencën Rajonale të ESG në WB6

20.03.2025, Prishtinë – Drejtori Ekzekutiv i OEMVP, z. Durim Zeqiri, ishte i ftuar si panelist në Konferencën Rajonale ESG WB6, e organizuar në kuadër të projektit për promovimin e praktikave të ESG (mjedis, shoqëri, qeverisje) nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë, në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore dhe partnerët e tjerë.



Z. Zeqiri ishte pjesëmarrës në panelin e parë të diskutimit me temë “Bashkëpunim rajonal për ESG – Forcimi i përpjekjeve ndërkufitare”. Ai theksoi implementimin e standardeve të larta dhe shkëmbimin e praktikave të mira mes vendeve të rajonit, duke e cilësuar si hap kyç për krijimin e një mjedisi më të qëndrueshëm biznesor dhe për të ndihmuar kompanitë në përshtatjen me kërkesat ndërkombëtare për qeverisje të mirë, përgjegjësi sociale dhe mbrojtje të mjedisit. Gjithashtu, potencoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional mes shteteve të Ballkanit Perëndimor, me çka do të kontribuohet në forcimin e konkurrueshmërisë së kompanive.

4.9 Realizohet Mbledhja e II-të e Këshillit Drejtues të OEMVP. U diskutuan prioritetet për periudhën që vijon

27.03.2025, Tetovë - Në hapësirat e kompanisë anëtare Hotel Mercure Tetovo, u realizua mbledhja e II-të e Këshillit Drejtues të OEMVP për vitin 2025, e udhëhequr nga Kryetari, z. Mendi Qyra.

Në këtë mbledhje të pranishëm ishin edhe Kryetari i Kuvendit të OEMVP z. Ejupi, nënkryetarët z. Aliu, z. Berisha dhe z. Asani, ku ky i fundit shtroi edhe iftar të përbashkët për të gjithë të pranishmit.



Me rast të 20 vjetorit të themelimit të OEMVP, temë kyçe e mbledhjes ishte organizimi i aktiviteteve në kuadër të së njëjtës. Ky jubile i rëndësishëm i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore këtë vit shënon 2 dekada të suksesshme të angazhimit dhe kontributit të saj për sektorin privat, si dhe ekonominë e vendit.

4.10 Maison de Parfum Skopje, kompania anëtare e OEMVP, hap dyert për vizitë ekskluzive

12.02.2025, Shkup - OEMVP vazhdon të mbështesë dhe promovojë anëtarët e saj, duke krijuar mundësi të reja rrjetëzimi dhe bashkëpunimi. Në kuadër të kësaj, kompania anëtare e OEMVP-së, Maison de Parfum hapi dyert për një vizitë ekskluzive, ku pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen nga afër me brendin, të eksplorojnë koleksionet unike të parfumeve Premium dhe të përfitojnë oferta speciale të dedikuara ekskluzivisht për ta.



Kryetari i Odës, z. Mendi Qyra, në fjalimin e tij përshëndetës foli për rëndësinë e bashkëpunimit mes bizneseve dhe rolin e OEMVP-së në krijimin e mundësive të reja për zhvillim.

4.11 Eksplorimi i tregjeve të reja: OEMVP organizon pjesëmarrjen e bizneseve anëtare në një nga panairët më të rëndësishme ndërkombëtare të ndërtimtarisë - CF Istanbul

14.02.2025, Stamboll - Përfaqësuesit e OEMVP nga kompanitë anëtare TRIM & LUM, Mi trans, Arh koncept, Ambrella Swiss Bau dhe GRADIS-KOO, ishin pjesëmarrës në ditën e parë dhe të dytë të panairit, ku patën mundësinë të zhvillojnë takime B2B me kompani ndërkombëtare, të eksplorojnë mundësitë për zgjerimin e tyre në tregjet e huaja dhe të shkëmbejnë ide për bashkëpunime potenciale në të ardhmen.



Ndërkohë, kompanitë Be Fix, Balkan Group dhe JU-SM-Bakiji vazhdojnë pjesëmarrjen e tyre ditëve në vijim, të cilët do përfitojnë nga mundësitë e rrjetëzimit me kompanitë e tjera pjesëmarrëse dhe promovimit të kompanive të tyre me të njëjtit.

Si pjesë e përkushtimit të saj për mbështetjen e kompanive anëtare duke i afruar më afër tregjeve ndërkombëtare, OEMVP ka mundësuar pjesëmarrjen e këtyre bizneseve nga Grupacioni i Ndërtimtarisë, Urbanizmit, Mjedisit dhe Energjetikës në këtë panair prestigjioz.

4.12 U realizua takimi ndërmjet Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore dhe Odës Ekonomike të Kosovës: Forcohet Bashkëpunimi Ekonomik Rajonal

01.04.2025, Shkup - në hapësirat e OEMVP-së mysafirët e sotëm ishin Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, z. Lulzim Rafuna, këshilltari tij, z. Haliti dhe Drejtori për marrëdhënie ndërkombëtare, z. Mustafa.

Mysafirët u mirëpritën nga Kryetari i OEMVP-së, z. Mendi Qyra, Drejtori Ekzekutiv, z. Durim Zeqiri, Menaxherja Operative, Miranda Ajdini dhe Bashkëpunëtorja për analizë dhe hulumtim, Genta Latifi.



Përpos rifillimit të bashkëpunimit mes dy institucioneve të mëdha në vendet respektive por edhe më gjrë, u diskutuan edhe mundësitë për bashkëpunim në nivel të projekteve nga grantet ndërkombëtare, Liberalizimi i tregut të fuqisë punëtore mes dy vendeve, aktualizimi i mundësisë për blerje të patundshmërive nga ana e qytetarëve të Kosovës në RMV, puna e përbashkët kundër eliminimit të barrierave të ndryshme për tregti mes dy vendeve (doganore, administrative etj.) si dhe shkëmbimi i ekspertizave dhe përvojave me qëllim të përmirësimit të klimës për biznes në vendet tona dhe për përmirësimin e kornizës ligjore që ka të bëjë me ekonominë.

4.13 OEMVP pjesëmarrëse në panairin “Medical and beauty fair – Tirana”

11.04.2025, Tiranë - Nga data 11 deri më 13 Prill 2025, në ambientet e Pallatit të Kongreseve në Tiranë po zhvillohet Medical & Beauty Fair, një nga ngjarjet më të rëndësishme në fushën e bukurisë, estetikës dhe teknologjisë së kujdesit personal në rajon, e organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë.

Në ngjarje mori pjesë edhe kryetari i OEMVP, z. Mendi Qyra, i cili mbështet promovimin dhe përfaqësimin e kompanive anëtare në ngjarje ndërkombëtare, me fokus në forcimin e bashkëpunimeve rajonale dhe shkëmbimin e përvojave në industri me potencial të lartë rritjeje.



4.14 Zhvillohet takim mes OEMVP dhe Prishtina REA – Në fokus bashkëpunimi për ndërlidhje të bizneseve

17.04.2025, Shkup - Kryetari i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, z. Mendi Qyra, priti në takim Drejtorin e Prishtina REA, z. Ahmet Jetullahu dhe z. Blerim Zllatku, për të diskutuar mundësitë për bashkëpunim me qëllim të ndërlidhjes së kompanive anëtare në aktivitetet e tyre.

Gjatë takimit, z. Jetullahu prezantoi punën dhe aktivitetet e ardhshme të Prishtina REA, duke theksuar përfshirjen e kompanive ndërkombëtare dhe mundësitë që ofrohen për ndërmarrësit në rajon. Ndërsa, nikoqiri z. Qyra shprehu gatishmërinë e OEMVP-së dhe të kompanive anëtare për të qenë pjesë aktive në këto iniciativa të rëndësishme për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik.



4.15 Kompanitë e OEMVP-së në skenën ndërkombëtare të ndërtimit në Stamboll

18.04.2025, Stamboll - Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore vazhdon të jetë urë lidhëse për ndërkombëtarizimin e bizneseve vendore. Këtë javë, OEMVP po përfaqësohet në një nga ngjarjet më të rëndësishme të sektorit të ndërtimit – Yapı – Turkeybuild Istanbul, një panair 4-ditor që zhvillohet në Stamboll, Turqi dhe që prej vitit 1978 shërben si pikë takimi për profesionistët e industrisë ndërtimore nga rajoni dhe më gjerë.

Në këtë panair janë të pranishme dy kompani anëtare, Pluska-Kompani dhe GRADIS-KOO, të cilat po prezantojnë veprimtarinë dhe produktet e tyre, po eksplorojnë mundësi bashkëpunimi, hyrje në tregje të reja dhe partneritete strategjike në një ambient dinamik dhe profesional.



4.16 Super Kompani prezente në panairin ndërkombëtar të ndërtimit në Bursë, Turqi

28.04.2025, Bursa - Në datat 24–27 Prill 2025 në Qendrën Ndërkombëtare të Panairit në Bursa, u mbajt panairi ndërkombëtar i ndërtimit dhe pronave të paluajtshme, ku morri pjesë kompania anëtare e Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, Super kompani.

Ky panair mbledhi mbi 1000 biznesmenë nga 70 shtete të ndryshme të botës, duke ofruar një platformë për prezantimin e materialeve më të avancuara ndërtimore, teknologjive të qëndrueshme si dhe inovacioneve më të fundit në këtë sektor. Ngjarja shërbeu gjithashtu si një mundësi konkrete për eksplorimin e tregjeve të reja për investim dhe nxitjen e bashkëpunimeve të reja në industrinë e ndërtimit dhe atë të pasurive të paluajtshme.



4.17 Kryetari i OEMVP, z. Mendi Qyra, dhe Drejtori, z. Durim Zeqiri, të pranishëm në ceremoninë e pranim-dorëzimit të detyrës së Rektorit të ri të Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup

28.04.2025, Shkup - Sot u mbajt ceremonia e pranim-dorëzimit të detyrës së Rektorit të ri të Universitetit, ku e njëjta iu dorëzua prof. Dr. Bekim Fetaji. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të OEMVP-së në këtë ngjarje thekson rëndësinë që Oda i kushton bashkëpunimit ndërmjet arsimit të lartë dhe sektorit privat.

OEMVP vazhdon të mbështesë nisma që synojnë krijimin e një kuadri profesional të përgatitur sipas nevojave të tregut të punës dhe zhvillimeve ekonomike.



4.18 Panairi i Karrierës në Universiteti i Tetovës - UT bashkon studentët me biznesin – pjesëmarrës edhe Kryetari i OEMVP-së, z. Mendi Qyra

29.04.2025, Shkup - Universiteti i Tetovës organizoi Ditën e Hapur dhe Panairin e Karrierës, një ngjarje e rëndësishme që bashkoi studentë, kompani dhe përfaqësues institucional.

Në këtë aktivitet mori pjesë edhe Kryetari i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, z. Mendi Qyra, i cili në deklaratën e tij për media theksoi:

“Ka një mungesë të ndjeshme të fuqisë punëtore në vend, kryesisht si pasojë e migrimit. Nga ky institucion i dijes, ne presim të dalin kuadro të përgatitura dhe të përshtatshme për nevojat e tregut të punës. Prandaj, shpresoj që bashkëpunimi ndërmjet arsimit dhe sektorit privat të vazhdojë edhe më fuqishëm në të ardhmen.”



4.19 OEMVP pjesëmarrëse në takime B2B me delegacionin e kompanive turke në Tiranë

06.05.2025, Tiranë - Kryetari i OEMVP-së, z. Mendi Qyra, së bashku me përfaqësues të kompanive anëtare të OEMVP, morën pjesë në ngjarjen e organizuar nga Shoqata e Eksportuesve të Anadollit Lindor (DAIB) dhe Asambleja e Eksportuesve Turk (TIM), me mbështetjen e Ministrisë së Tregtisë së Turqisë.

Në këtë ngjarje, OEMVP u nderua me dhuratë simbolike nga organizatorët, si shenjë respekti dhe mirënjohjeje për kontributin e vazhdueshëm institucional në forcimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve, meritë kjo e partneritetit të Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë me në krye Kryetarin e saj z. Nikolin Jaka. Ky moment u shoqërua me falënderime të ndërsjella, duke theksuar gatishmërinë e përbashkët për avancimin e marrëdhënieve tregtare dhe investuese.



4.20 Birraria Shkup, EVN, Eko fluid dhe Sparkasse Bank mbështesin aksionin “Generalka Weekend 2025” për një të ardhme të gjelbër

13.05.2025, Shkup - OEMVP vlerëson dhe promovon kontributin dhe praktikat me përgjegjësi shoqërore, duke i cilësuar ato si shtyllë të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social. Së fundmi kompanitë anëtare dhe njëherit edhe sponsorët e Odës ishin pjesë e iniciativës “Generalka Weekend”, aksioni ekologjik për një mjedis më të pastër, i mbajtur prej 9 deri më 11 maj, 2025, në të gjitha komunat e Maqedonisë së Veriut.



Пивара Скопје / Pivara Skopje, partner strategjik dhe mbështetës kryesor i aksionit, për të tretin vit radhazi, Eko Fluid, me përkushtim të palëkundur për mbrojtjen e mjedisit, po ashtu Sparkasse Bank AD Skopje, pjesëmarrëse e rregullt dhe promotore e vlerave të qëndrueshmërisë përmes platformës #SparkasseLife dhe EVN Maqedoni, që në vazhdimësi kontribuon në zhvillim të qëndrueshëm dhe efikasitet energjetik.

4.21 OEMVP mirëpret studentët e Fakultetit të Biznesit dhe Ekonomisë të South East European University (SEEU)

14.05.2025, Shkup – Në hapësirat e Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, Kryetari, Mendi Qyra, dhe Drejtori Ekzekutiv, Durim Zeqiri, pritën studentët të Fakultetit të Biznesit dhe Ekonomisë, si dhe përfaqësues nga Parlamenti dhe Asociacionit Studentor i UEJL, të udhëhequr nga kryetari i tyre, Agron Muharemi.



Të njëjtët realizuan një vizitë studimore me qëllim që të njihen më nga afër me punën e Odës që nga themelimi i saj, aktivitetet më të fundit, zhvillimet në komunitetin e biznesit vendor, si dhe me iniciativat që ky institucion ndërmerr për krijimin e kushteve që të rinjtë të ndërtojnë karrierën e tyre në vend, duke shmangur aspiratat për migrim.

4.22 OEMVP pjesëmarrëse në konferencën ekonomike të organizuar nga Rrjeti Global i Bizneseve Shqiptare

16.05.2025, Prishtinë - U mbajt konferenca e organizuar nga Rrjeti Global i Bizneseve Shqiptare, ku me ftesë të kryetarit të së njëjtës z. Omer Nura, morën pjesë edhe përfaqësuesit më të lartë të Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, Kryetari, z. Mendi Qyra, Kryetari i Kuvendit, z. Nazmi Ejupi, si dhe Kryetari i Nderit, z. Xhemail Dauti, së bashku me kompanitë anëtare Pluska Kompani dhe Gradis KOO.



Kryetari Qyra u nderua me një fjalë rasti, dhe i njëjti theksoi bashkëpunimin e qëndrueshëm dhe efektiv me Odat Ekonomike të Kosovës dhe Shqipërisë, si dhe rëndësinë e Rrjetit Global të Bizneseve Shqiptare, duke i falënderuar për iniciativën e tyre që krijojnë një urë lidhëse të rëndësishme për dialog, shkëmbim përvojash dhe zhvillim të përbashkët ekonomik ndërmjet bizneseve shqiptare.

4.23 OEMVP mirëpret në takim udhëheqësinë e Lidhjes së Bizneseve të Kosovës

21.05.2025, Shkup – Kryetari i OEMVP, z. Mendi Qyra, së bashku me nënkryetarin z. Aliu, anëtarin e Këshillit Drejtues z. Morina, drejtorin ekzekutiv z. Durim Zeqiri dhe menaxheren operative znj. Miranda Ajdini, mirëpritën në takim Kryetarin z. Besart Dreshaj dhe përfaqësues të bordit të Lidhjes së Bizneseve të Kosovës.



Ky takim përfshiu diskutime mbi mundësitë e bashkëpunimit në çështje të rëndësishme që ndikojnë drejtpërdrejt në klimën afariste dhe zhvillimin ekonomik në të dy vendet.

4.24 OEMVP zhvillon Mbledhjen e III-të të Këshillit Drejtues në Strugë

25.05.2025, Strugë – Në hapësirat e Ėmbla Hotel & Spa në Strugë u zhvillua Mbledhja e III-të e Këshillit Drejtues të Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, e thirrur nga Kryetari z. Mendi Qyra. Mbledhja mbledhi anëtarët e Këshillit drejtues, Mbikëqyrës, Drejtorin Ekzekutiv dhe Menaxheren operative për të diskutuar temat kyçe që lidhen me zhvillimin strategjik të Odës dhe aktivitetet e ardhshme institucionale.



Në fokus të mbledhjes ishin përgatitjet për shënimin e 20-vjetorit të themelimit të OEMVP-së, një moment historik për institucionin dhe komunitetin e biznesit që përfaqëson.

4.25 OEMVP në skenën digjitale të Ballkanit – Jeton Asani flet për fuqinë e teknologjisë në biznes

26.05.2025, Prishtinë - Nënkryetari i OEMVP, z. Jeton Asani, njëkohësisht themelues i kompanisë Gigabel, mori pjesë si folës në ngjarjen e organizuar nga Prishtina REA, "BALKONNECT FESTIVAL 2025", e mbajtur në Prishtinë.

Ai ishte pjesë e sesionit tematik "Inovacioni Digjital – SaaS, AI dhe Teknologjitë në Zhvillim", ku ndau njohuritë dhe përvojën e tij mbi mënyrat se si teknologjia mund të fuqizojë bizneset dhe të përshpejtojë proceset e transformimit digjital, menaxhimi dhe siguria e të dhënave, ndikimi i teknologjive në zhvillim në tregun vendor dhe ndërkombëtar, inteligjenca artificiale dhe sfidat nga e njëjta.



4.26 OEMVP realizoi me sukses mbledhjen e Kuvendit vjetor për vitin 2025

31.05.2025, Shkup – U mbajt mbledhja vjetore e Kuvendit, nën drejtimin e Kryetarit të Kuvendit, z. Nazmi Ejupi, ndërsa të pranishëm ishin edhe Nënkryetari i Kuvendit të OEMVP, z. Kasam Zendeli, kryetari Qyra dhe anëtarët e KD, Drejtori ekzekutiv z. Durim Zekiri, si dhe anëtarët e kuvendit.

Mbledhja u hap nga z. Ejupi, ndërsa kryetari i OEMVP z. Qyra në fjalën e tij përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi anëtarët për kontributin e tyre të vazhdueshëm. Gjithashtu, potencoi ecurinë e impaktit dhe aktivitetet e OEMVP përgjatë viteve të fundit, ku së bashku me Drejtorin Ekzekutiv, anëtarët e Bordit dhe stafin, si dhe bashkëpunëtorët, janë arritur zhvillime të mëdha ekonomike të cilat janë në favor të sektorit privat.



4.27 Kryetari dhe Drejtori ekzekutiv së bashku me kompani anëtare të OEMVP të pranishëm në Panairin e përgjithshëm ndërkombëtar “Prishtina 2025”

10.06.2026, Prishtinë – Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore e përfaqësuar nga Kryetari Mendi Qyra dhe Drejtori ekzekutiv Durim Zeqiri, zyrtarisht mori pjesë në Panairin e përgjithshëm ndërkombëtar “Prishtina 2025”. Pjesëmarrës në këtë ngjarje ishin edhe kompanitë anëtare Sal Kom, Pluska-Kompani dhe GRADIS-KOO

Kryetari z. Qyra në fjalimin e tij përshëndetës, potencoi se bashkëpunimi mes Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore dhe Odës Ekonomike të Kosovës është i domosdoshëm, duke pasur parasysh se kompanitë operojnë dhe shtrijnë aktivitetet e tyre në shtetet përkatëse, dhe se ngjarje të tilla rrjetëzuese janë platformë ideale që ju mundësojnë bizneseve promovim dhe shkëmbim kontaktesh me bashkëpunëtorë potencial.



4.28 Kompania anëtare e OEMVP, BE-DA Logistics pjesëmarrëse në panairin “Transport Logistic 2025” në Mynih

11.06.2025, Mynih - Kompania BE-DA Logistics ishte pjesëmarrëse në panairin botëror për transport dhe logjistikë – Transport Logistic 2025, i cili u mbajt nga 2 deri më 5 qershor në Mynih, Gjermani. Kjo ngjarje përbën një nga platformat më të rëndësishme për lidhjen e kompanive udhëheqëse në sektorin e logjistikës.

Stenda e BE-DA Logistics ishte pikë takimi për shumë vizitorë, nga bashkëpunëtorët afatgjatë deri te partnerët e mundshëm të rinj, duke theksuar edhe një herë besimin që kompania ka ndërtuar ndër vite.



4.29 OEMVP mirëpret në takim kryesinë e Klubit të Biznesit Maqedoni-Gjermani

11.06.2025, Shkup - Në hapësirat e Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore Kryetari z. Qya së bashku me nënkryetarin Aliu, drejtorin ekzekutiv Zekiri, anëtarë të KD dhe menaxheren operative mirëpritën në takim Klubin e Biznesit Maqedoni-Gjermani, me kryetarin Vejseli, nënkryetarin Ilijevski dhe anëtarë të tjerë nga kryesia.

Takimi u përqendrua në identifikimin e sektorëve me potencial të lartë investimi dhe zhvillimi, veçanërisht në sektorët deficitare si energjetika, ku nevojiten investime serioze dhe të qëndrueshme. Palët theksuan rëndësinë e krijimit të kushteve të favorshme për investitorët dhe tërheqjes së kapitalit të ri në vend.



4.30 Drejtori ekzekutiv i OEMVP në vizitë te kompania anëtare Tiamo – model suksesi i industrisë vendore

12.06.2025, Shkup - Në kuadër të programit Roadshow, Drejtori Ekzekutiv i OEMVP, z. Durim Zekiri, dhe Menaxherja Operative, Miranda Ajdini u mirëpritën në takim nga z. Hajrun Sulejmani, pronar i kompanisë Tiamo dhe përfaqësues të tjerë nga kompania.

Gjatë takimit u diskutua për sfidat me të cilat përballen kompanitë vendore prodhuese, rëndësia e krijimit të kushteve më të favorshme për bizneset prodhuese, ruajtja e fuqisë punëtore në vend, mbështetja institucionale dhe lehtësirat fiskale dhe doganore. U vizituan edhe hapësirat ku realizohet e gjithë veprimtaria me teknologjitë më të avancuara në vend.



4.31 "OEMVP hap kampanjën e 20-vjetorit: 2 dekada rrugëtim i përbashkët, fillojnë me një marsh simbolik drejt Ujëvarave të Kamjanit"

15.06.2025, Kamjan - Sot, në një atmosferë frymëzuese mes bukurive natyrore të Ujëvarave të Kamjanit, Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore hapi zyrtarisht kampanjën për shënimin e 20-vjetorit të themelimit me një marsh simbolik që do të mbetet në kujtesë si fillimi i një kapitulli të ri për Odën dhe anëtarësinë e saj.

Në këtë marsh të veçantë morën pjesë drejtuesit më të lartë të Odës: Kryetari z. Mendi Qyra, Kryetari i nderit, Kryetari i Kuvendit, anëtarët e Këshillit Drejtues dhe Mbikëqyrës, anëtarë të Odës, si dhe Zyra Ekzekutive e udhëhequr nga Drejtori ekzekutiv z. Durim Zekiri.



4.32 Kryetari Mendi Qyra, Drejtori Durim Zeqiri dhe Kryetari i Grupacionit të energjetikës z. Morina pjesëmarrës në MEF Energy Forum 2025

18.06.2025, Shkup - Kryetari i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, z. Qyra, së bashku me Drejtorin Ekzekutiv z. Zekiri dhe anëtarin e Këshillit Drejtues, njëkohësisht Kryetar i Grupacionit të ndërtimtarisë, urbanizmit, mjedisit dhe energjetikës, z. Morina, morën pjesë në edicionin e 8-të të MEF Energy Forum 2025, një ndër ngjarjet më të rëndësishme rajonale në sektorin e energjisë, e organizuar nga Zip Institute, nën patronazhin e Ministrisë së energjetikës dhe Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.



Një ndër pikat strategjike të OEMVP për periudhën 2024-2027 është rruga drejt institucioneve dhe bizneseve moderne të digjitalizuara dhe të drejtuara drejtë ekonomisë cirkulare dhe burimeve të ripërtitshme të energjisë.

4.33 Drejtori Ekzekutiv, z. Durim Zeqiri, folës në forumin Rinor për demokracinë ekonomike dhe pronësinë e punonjësve

19.06.2025, Shkup – Drejtori Ekzekutiv i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore z. Durim Zekiri ishte panelist në Forumin rinor për demokracinë ekonomike dhe pronësinë e punonjësve, i cili u organizua në kuadër të projektit “Duke formësuar të ardhmen e punës”, i zbatuar nga organizata ARNO dhe Instituti për Demokraci Ekonomike nga Sllovenia.



Në këtë panel morën pjesë edhe Sebastjan Pikel nga Instituti për Demokraci Ekonomike (IED), Prof. Dimitar Jovevski nga Fakulteti Ekonomik pranë Universitetit Shën Qirili dhe Metodi dhe znj. Aleksandra Sholdova Spasovska nga organizata Women in Tech.

4.34 OEMVP mirëpret Kryetarin e Odës Ekonomike Brazilo-Maqedonase: Hapet perspektiva për bashkëpunim Maqedoni e Veriut-Brazil

25.06.2025, Shkup - Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore në vazhden e angazhimeve të saja për zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe promovimin e potencialeve ekonomike të vendit, zhvilloi takim me z. Luis Fernando del Valle – Kryetar i Odës Ekonomike Brazilo-Maqedonase (BRA-MAK) dhe kandidat për Konsull nderi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në Sao Paulo, Brazil.

Delegacioni i OEMVP-së, i përbërë nga Kryetari z. Mendi Qyra, Drejtori ekzekutiv z. Durim Zeqiri, Nënkryetari z. Asani dhe anëtarët e Këshillit Drejtues, z. Mustafa dhe znj. Aliu, mirëpriti z. del Valle në ambientet e Odës, ku u zhvilluan diskutime substanciale mbi mundësitë e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Brazilit.



5. Zvogëlimi i ekonomisë gri (joformale), minimizimi i korrupsionit dhe konkurrencës jo lojale si parakusht i konkurrueshmërisë së shëndoshë ekonomike

5.1 Fushata e OEMVP për sensibilizim kundër Ekonomisë gri (joformale)

12.03.2025 - Avantazhet e formalizimit të biznesit.



5.2 OEMVP me kërkesë zyrtare: Sektori i ndërtimtarisë të përjashtohet nga ndalesa e punës të dielave

27.05.2025 – Duke qenë se puna në ndërtimtarë është e varur nga kushtet klimatike dhe mund të realizohet në mënyrë të plotë vetëm gjatë disa muajve të vitit, dita e diel përbën një mundësi të rëndësishme për të rritur efikasitetin dhe respektimin e afateve kohore në realizimin e projekteve ndërtimore.

Andaj, me datë 23 maj 2025, Grupacioni i ndërtimtarisë pranë OEMVP ka dërguar shkresë zyrtare deri tek Qeveria dhe Institucionet përkatëse duke propozuar përfshirjen e sektorit të ndërtimtarisë në përjashtimet nga ndalesa për punë të dielave, në përputhje me natyrën specifike të sektorit dhe rëndësinë e tij për ekonominë.



6. Mbledhjet e organeve të OEMVP

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, Këshilli Drejtues, si organ udhëheqës i Odës, ka vazhduar me ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi të tij, të përcaktuara me Ligj, Statut dhe Rregullore për punë. Në këtë periudhë janë mbajtur gjithsej tri mbledhje të rregullta, si më poshtë:

- Mbledhja e parë e Këshillit Drejtues – mbajtur më 27.01.2025;
- Mbledhja e dytë e Këshillit Drejtues – mbajtur më 27.03.2025;
- Mbledhja e tretë e Këshillit Drejtues – mbajtur më 25.05.2025.

Gjithashtu, më **31.05.2025** u mbajt edhe **Mbledhja e Kuvendit të OEMVP**, organi më i lartë udhëheqës i Odës Ekonomike.

7. Marrëdhëniet me publikun

- **08.01.2025** - Qyra: Tregu ynë kombëtar ka 60 mijë kilometra katror, duhet ta shfrytëzojmë si komb këtë potencial

https://www.facebook.com/oemvp.org/posts/pfbid0yxVLmXGa7rvWw7uWedt8h2qzfZj79WjS1g7cbR7zg_dse9Ek4uNNSCCUJG1LwHERSI

- **09.01.2025** - Klan Debat – Mendi Qyra

<https://www.facebook.com/oemvp.org/posts/pfbid02cxU41UXnuHBEzjPHWFSeXk6M4qo5gYEFuWUyAV5W3yUo8nH9TXsDjfAq7Vd6M76I>

- **15.01.2025** - Drejtori Ekzekutiv i OEMVP - z.Durim Zeqiri, në debatin Televiziv të TV 24 "24 Отворено"

<https://www.facebook.com/oemvp.org/posts/pfbid02YZnkk68TnSPiZisZHH8nqptWTe4bjupTJs8iWet56bacQArJPLfJ7Lh8JySH4MFXI>

- **24.01.2025** - Në linkun e mëposhtëm ndiqni intervistën e z. Sami Morina - anëtar i Këshillit Drejtues të OEMVP, në emisionin Biznes plus në Televizioni i Maqedonisë - TVM2.

<https://www.facebook.com/oemvp.org/posts/pfbid0eiubz31ez599quwkhXpoBBLGVbVLSdiu8UKk2duxfTXNRDRW88XNDn37t4wv6WZol>

- **30.01.2025** - Nënkrjetari i Kuvendit të OEMVP, z. Kasam Zendeli në debatin televiziv të TV Telma "Top Tema"

<https://www.facebook.com/oemvp.org/posts/pfbid0gd6pfmBMYqQ9Lz4CL7FYiEAewbgxUAw9FPeJ1q6Jzb4WovilJGxpRbRCYxVBA9Vl>

- **31.01.2025** - Kryetari i OEMVP, z. Mendi Qyra për Radio Evropa e Lirë: "Ende nuk mund të thuhet se tregu i çmimeve është stabil, ndaj është e nevojshme të merren masa adekuate për rregullimin e tyre, veçanërisht për produktet bazë të përditshme".

https://www.evropaelire.org/a/ballkani-perendimor-thirrje-per-bojkot-te-supermarketeve-/33297626.html?fbclid=IwY2xjawJrKlxleHRuA2FibQlxMQABHvGj9Fadf-Gl6jONW0jhqzqMIH62tdboQJhu45Fhn2FO1qPWZTOlaoV31TOoj_aem_Vp3E6YQRiPPBNmYMGcdFOQ

- **04.02.2025** - Në linkun e mëposhtëm mund të ndiqni Kryetarin e OEMVP, z. Mendi Qyra në emisionin "Klan Debat" në Klan Maqedoni, ku u diskutua mbi Bojkoti i marketeve : Alarm dhe mesazh serioz nga qytetarët.

<https://www.facebook.com/oemvp.org/posts/pfbid02qVUjLdoV4KR2QKNWEXg3xFHykui4RgwfcUCKpxeGRkdVBRtEXtVvm8ySdoHwpCANl>

- **13.02.2025** - Ndiqni deklaratën e kryetarit të OEMVP, z. Mendi Qyra për TV 24, lidhur me kufizimin e marzhave dhe se sa ato do të përmirësojnë standardin dhe varfërinë.

<https://www.facebook.com/oemvp.org/posts/pfbid02UsJSMHUCJdCwB5TLnQVUENLgLGmmJJRqjEdswc qkojqCUWS2dYsQBgBACDDW7XSLI>

- **21.02.2024** - Në vazhdim mund të ndiqni intervistën e Drejtorit Ekzekutiv të OEMVP, z. Durim Zeqiri, mbi kufizimin e marzhës bruto të fitimit, vendimi i fundit i Qeverisë i cili do zbatohet deri me datë 30 prill

<https://www.facebook.com/oemvp.org/posts/pfbid034bh3usns7kcHzJjVsMowNnECKmukNGJGG283PM Ze4LkoQ5gT36GYXHURhQwQWH2I>

- **22.02.2025** - Kryetari i OEMVP, z. Mendi Qyra, i ftuar në #PikëPodcast

<https://www.facebook.com/oemvp.org/posts/pfbid0f5DmBjPjFFc7Sh4ajmC33UjNnqfu5FABJ2iZFu8gZF8 7TrnjLUdFJdyd39o7JEGI>

- **07.03.2025** – Durim Zeqiri në emisionin Biznes Plus në RTMV2

<https://www.facebook.com/oemvp.org/posts/pfbid03co2yVjWTFy16jac16RhjvTPjbKXKQUGGkXeFvPKk9 BfvUDLjgmsxZy2LQ9tHRHl>

- **13.03.2025** - Kryetari i OEMVP, z. Mendi Qyra i ftuar në Zëri i Amerikës: Të rritet paga minimale në 500 euro, por të ulen kontributet.

<https://www.facebook.com/oemvp.org/posts/pfbid031d91eRfrTHDvZCuCK65h82rbey7Sr9Vse5zTrzMen1 bczfzLX9c9UcGJPavMLEs4I>

- **19.03.2025** – Kryetari i OEMVP, z. Mendi Qyra, i ftuar në podcast "Weconomy"

<https://www.facebook.com/oemvp.org/posts/pfbid024rKsF2Bj7RQCgG8BMxPsKNJJFHLVm5dnhhxxCJHkc bjBMRDqgbtDotSe6CuzngZCI>

- **30.03.2025** - Durim Zeqiri për Kosova Press - Bashkëpunimi ekonomik Kosovë-Maqedoni e Veriut, këto janë sfidat dhe mundësitë për zhvillim

https://kosovapress.com/bashkepunimi-ekonomik-kosove-maqedoni-e-veriut-keto-jane-sfidat-dhe-mundesite-per-zhvillim?fbclid=IwZXh0bgNhZW0CMTEAAR3Q8_uVFCopCEbIXwT1ABCRrwXgLF83U_ZauOAY_1xI04akW38JBpLbco_aem_oqPLZwbjX-LxaAGE3G1viA

- **03.04.2025** - Kryetari i OEMVP, prononcim lidhur me vendosjen e tarifave të reja nga SHBA

<https://www.facebook.com/alsatnmk/videos/997354119208262>

- **10.04.2025** - Drejtori i OEMVP, z. Durim Zeqiri deklaratë për Alsat M

https://www.facebook.com/watch/live/?mibextid=wwXlfr&ref=watch_permalink&v=1325458241864752&rdid=sv2BM0e2hcU1Pmfq

- **13.04.2025** - Kryetari Qyra, Qeveria humb betejën për tatimin e solidaritetit, kompanive do t'u kthehen 50 milionë euro

<https://zhurnal.mk/qeveria-humb-betejen-per-tatimin-e-solidaritetit-kompanive-do-tu-kthehen-50-milione-euro/>

- **17.04.2025** - Kryetari i OEMVP, z. Mendi Qyra në emisionin debativ "Biznes Plus"

https://www.youtube.com/watch?v=LCPxyU-BMOI&fbclid=IwY2xjawJu6Q9leHRuA2FIbQIxMQABHuXEtk_Esj3mAk2-UHUvqOunt8_SN7_krgbAVS9A3IQqOGrNsQBMUSWcHKUI_aem_2Mc9nuLWt389Cd69fzqoGw

- **17.04.2025** - Zeqiri: Paga minimale 500 euro është kërkesë autoktone e Odës Ekonomike

<https://shenja.tv/zeqiri-paga-minimale-500-euro-eshte-kerkese-autentike-e-odes-ekonomike/>

- **20.04.2025** - Shporta e konsumatorit nuk duhet të zvogëlohet nga një familje me katër anëtarë në një me tre anëtarë – Mendi Qyra

<https://telma.com.mk/2025/04/20/potroshuvachkata-koshnichka-ne-smee-da-se-krati-od-chetirichleno-na-trichleno-semejstvo-intervju-so-mendi-kura/>

- **10.05.2025** - Drejtori i OEMVP, z.Durim Zeqiri deklaratë mbi: STËRZGJATJEN E PROCEDURAVE NË PIKAT KUFITARE QAFË THANË DHE BLLACË - OEMVP: PO DËMTOHEN NGARKESAT ME PRODUKTET BIMORE

<https://www.facebook.com/watch/?v=692330596717799>

- **24.05.2025** - Kryetari Qyra, i ftuar në RTMV1

<https://play.mrt.com.mk/play/585038>

- **04.06.2025** - Durim Zeqiri i ftuar në emisionin “Çka s'thuhet” në Ora24

<https://www.facebook.com/ora24.tv/videos/1674981323180345/>

- **08.06.2025** - Çmimet e banesave në rritje të vazhdueshme, Qyra: Nuk pritet ulje e çmimeve për banesa

<https://al.mrt.com.mk/node/141357>

- **20.06.2025** - Реакции за ребалансот на буџетот: Вложувањата во инфраструктурата ќе го поттикнат економскиот раст

<https://alfa.mk/vlozhuvanata-vo-infrastrukturata-ke-go-pottiknat-ekonomskiot-rast/>

- **27.06.2025** - Kryetari i OEMVP-së Mendi Qyra, i ftuar në promovimin e investimit për ujësjellësin në Strugë

<https://www.facebook.com/watch/?v=650467164673775>

7. Komunikimi me anëtarët

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, Desku i shërbimeve ka realizuar mbi 1100 kontakte me kompani në forma të ndryshme (thirrje telefonike dhe e-mail) dhe njëkohësisht Desku i shërbimeve është kontaktuar rreth 1000 herë.

Gjithashtu gjatë gjashtë mujorit të parë, në OEMVP janë anëtarësuar gjithsej 15 kompani të reja.

8. OEMVP në media

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2025, përfaqësues të OEMVP kanë qenë prezent në media 31 herë, ndër të cilat:

- në emisione – 14;
- deklarata në TV – 15;
- deklarata në media të shtypura – 2

Gjithashtu, gjatë periudhës së njëjtë OEMVP është cituar mbi 400 herë.


9. OEMVP në rrjetet sociale

OEMVP, me përfundimin e gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, në rrjetin social FACEBOOK numëron gjithsej:

- 8,652 ndjekës;
- 8,024 pëlqime të profilit.

Krahasuar me vitin paraprak periudhën e njëjtë, kemi rritje të pëlqimeve të profilit për 3.14%, ndërsa rritje të ndjekësve për 1.93%

Ndërkaq, OEMVP është aktive edhe në rrjetet tjera sociale dhe atë INSTAGRAM ku gjithsej numëron 555 ndjekës dhe LinkedIn me gjithsej 182 ndjekës.



Shërbimet e OEMVP

Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore është një partner që ndihmon bizneset në rrugën e tyre drejt suksesit afarist përmes një game të gjerë shërbimesh.



SHËRBIMET INFORMATIVE – Anëtarët e OEMVP-së kanë mundësi të informohen nëpërmjet kanaleve të informimit në fushat e tyre të interesit siç janë: Informatori ekonomik **ECONOMICUS**, Biznes informatori **DOBIA**, Informatori Juridik **JURIS** dhe **JURIS ALARM**, **BULETINI I OEMVP-së**, **THIRRJE PËR TENDERË NDËRKOMBËTARË**, **PANAIRE RAJONALE DHE NDËRKOMBËTARË**.



SHËRBIMET PROMOVUESE – OEMVP nëpërmjet shërbimeve promovuese të saj, mbështet anëtarët e saj duke i promovuar të njëjtit, duke përfshirë këtu, kompanitë start-up, kompanitë të cilat kanë lancuar shërbim të ri, kompanitë që kanë oferta të reja promovuese, etj. Roli i odës është ti promovojë të njëjtit përmes: promovimit në **Rrjetet sociale**, shërbimit “**Anëtari për Anëtarin**” (nëpërmjet e-mailit), **Logo në web faqen e OEMVP**, **video në korridorin e OEMVP**, **materiale promovuese në sallën e takimeve të odës si dhe katalogu TOP 100™**.



QENDRA E TRAJNIMEVE- Qendra e trajnimeve të OEMVP-së është aktive për të ju shërbyer kompanive me trajnime të temave të ndryshme, duke përmbytur nevojat e tyre për trajnim dhe përgatitje të kuadrove të tyre. Trajnimet kryhen në bazë të **Planit vjetor të OEMVP-së** apo sipas kërkesave specifike të anëtarëve.



QENDRA PËR CILËSI DHE STANDARDE - Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore përmes Qendrës së saj për cilësi dhe standarde, anëtarëve Ju ofron: **ISO Standarde**, **HASSP Standarde**, **Halal Standarde**.



KONSULENCA DHE ANALIZA – Ky shërbim përfshin: **Konsultime (ligjore dhe ekonomike)**, **Analiza financiare sipas kërkesës**, **Shërbime patentimi**, **Shërbime të pronësisë intelektuale**, **Kërkesa drejtuar institucioneve**.



SHËRBIMET E TJERA - Çertifikata e Origjinës, Çertifikata e Origjinës-Elektronike, Lobim, Lobim sipas kërkesave individuale, Ftesë për panaire virtuale për ndërlidhje të bizneseve me regjionin, Shërbime administrative, B2B takime, Qasje deri te Grupacionet e Odës, Ftesë në ngjarjet e OEMVP-së (seminare, konferenca, samite), Vende të rezervuara në çdo ngjarje të OEMVP-së, Asistim për pjesëmarrje në panaire të ndryshme botërore, Përfaqësim i interesave të anëtarësisë para institucioneve shtetërore dhe ndërkombëtare, Drekë me kryeministrin/presidentin/ministrat, Iftari Tradicional, Vërtetim për anëtarësi.



SHËRBIME TEKNIKE – Hapësira të lira për anëtarët në zyrat e OEMVP-së për takime dhe biseda biznesore (deri 1 orë), Sallë për shfrytëzim njëditor dhe disaditor (deri 15 vende).



KATALOGU TOP 100™ - Katalogu TOP 100™ i kompanive më të suksesshme në Maqedoninë e Veriut është një platformë rrjetëzimi dhe promovimi, ku promovohen bizneset e suksesshme, por gjithashtu krijohen mundësi të reja për bashkëpunime potenciale mes anëtarëve ekzistues dhe anëtarëve potencial. Ky katalog ofron një mundësi të shkëlqyeshme, për kompanitë që duan të prezantojnë produktet dhe shërbimet e tyre para një audience të gjerë, duke stimuluar vizibilitetin e tyre dhe forcimin e pozicionit në treg, dhe njëkohësisht duke i bërë kompanitë më konkurruese në tregun vendor dhe ndërkombëtar.